



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar zonja e zotërinj anëtarë,

Viti 2023 ishte një vit sfidues për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm për shkak të çështjeve administrative dhe procedurale që lidheshin me zbatimin e hartës së re gjyqësore dhe vijimit të uljes së numrit të prokurorëve si pasojë e pezullimit apo shkarkimit gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar. Megjithatë, përpjekjet dhe profesionalizmi i prokurorëve në të gjithë nivelet pavarësisht ngarkesës, dhe bashkëpunimi institucional dhe ndërinstitutional, dhanë rezultate në punën hetimore dhe zbatimin e rekomandimeve drejtuar prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, siç do të paraqitet në vijim.

Përgjatë vitit 2023 vlerësoj se janë arritur rezultate në një sërë objektivash në fokusin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme, kjo në sajë edhe të masave administrative dhe procedurale institucionale, siç janë miratimi i udhëzimeve të përgjithshme dhe planeve të veprimit për të vijuar unifikimin e veprimtarisë së prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe mbikëqyrja e zbatimit tyre. Kujdes i veçantë i është kushtuar vijimit të zbatimit të akteve të përbashkëta me institucione e agjenci ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, si dhe miratimit të marrëveshjeve të reja për të rritur efektivitetin e bashkëpunimit ndërinstitutional. Kështu, ndër këto masa veçojmë:

- masat për ndjekjen e rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë nëpërmjet, detajimit në planin e veprimit të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, të aktiviteteve të nevojshme për adresimin e çdo rekomandimi, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij.

- masat për ndjekjen e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023” nëpërmjet, miratimit dhe zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, miratimit me urdhrin nr. 70/2023 të planit të veprimit me aktivitete të

qarta për zbatimin e rekomandimeve prioritare. Në këto akte udhëzohen masa administrative dhe procedurale për drejtuesit e prokurorive, drejtuesit e seksioneve dhe prokurorët, për të rritur angazhimin proaktiv, koordinimin dhe bashkëpunimin brenda prokurorisë dhe me prokurori të tjera e me institucionet ligjzbatuese, konsolidimin e kapaciteteve dhe menaxhimin efektiv të punës duke prioritetizuar veprat penale të rekomanduara për një sistem prokurorie efikas.

- Masat e marra për ndjekjen e objektivave prioritare institucionale në luftën kundër kriminalitetit, ku fokus të veçantë edhe në vitin 2023 kishte vepra penale e pastrimit të parave, vijimi i punës për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme, zbatimin e hartës gjyqësore, digjitalizimin, monitorimin e veprimtarisë së policisë gjyqësore, bashkërendimin me institucione të drejtësisë dhe ato ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, forcimi i kapaciteteve institucionale.

- Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar dhe ka kontribuar në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit në Bashkimin Europian, fokusuar në realizimin e masave ku veçojmë: raportimet periodike për progres raportin për kapitujt 23 e 24, planin e veprimit FATF/ICRG, raportimet për Nënkomitetin Drejtësia, Liria dhe Siguria, dhënien e kontributit në hartimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës.

- Në kuadrin e hartës së re gjyqësore, Prokuroria e Përgjithshme është përfshirë dhe angazhuar në fazën e zbatimit të hartës së re gjyqësore në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Ministrinë e Drejtësisë. Për të unifikuar veprimtarinë procedurale dhe mirëregulluar aktivitetin administrativ institucional u synua ndërhyrja me akte nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm.

Gjatë vitit 2023, grupi i punës i ngritur me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, ka ndjekur mbarëvajtjen e procesit dhe ka propozuar marrjen e masave administrative të nevojshme në mënyrë që riorganizimi i prokurorive dhe mbarimi juridik/mbyllja e disave prej tyre, të bëhej në një kohë sa më të shpejtë e duke zgjidhur çdo problematikë të mundshme.

Në kuadër të zbatimit të udhëzimit nr. 1/2023 “Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”, u identifikuan, administruan dhe inventarizuan aktet, dokumentet, regjistrat dhe arkivat për të mundësuar funksionimin sa më të shpejtë me qëllim garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të personave nën hetim, të pandehurve e viktimave në procesin penal, ruajtjen e sekretit të hetimeve apo ndalimin e publikimit të akteve procedurale penale, sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve për publikun në prokurori, sipas afateve e kriterëve ligjore të përcaktuara.

Pas studimit të strukturave organike, u planifikua shpërndarja e burimeve njerëzore për të siguruar numrin e nevojshëm të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe stafit mbështetës për garantimin e një ngarkese sa më proporcionale të punës.

U transferuan/bashkuan shërbimet e aseteve informatike për gjithë prokuroritë, duke garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e tyre nga humbja, aksesit i të tretëve, vijimin e

shërbimeve, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të aspekteve të sigurisë në prokuroritë e të gjitha niveleve.

Sa i përket kapaciteteve akomoduese, duke njohur problematikat lidhur me infrastrukturën e pamjaftueshme janë planifikuar disa masa që për realizimin e tyre kërkojnë angazhim ndërinstitucional. Këtu përmendim: në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, kanë vijuar punimet në kuadër të investimit për shtimin e një kati ndërtese i cili do të krijojë hapësira të nevojshme për akomodimin e të gjithë stafit të kësaj prokurorie. Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, i është kërkuar Bashkisë Fier marrja në administrim e një godine tjetër. Ka përfunduar detyra e projektimit nga Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorinë Tiranë, për ndërtimin e një godine të re akomodimi për të gjitha institucionet e sipërcituara. Pas vënies në dispozicion nga Bashkia Tiranë të një sheshi ndërtimi do të vijohet me hartimin e projektit. Kemi kërkuar angazhimin e Ministrisë së Drejtësisë për realizimin e marrëveshjes ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë për vënien në dispozicion të ambienteve akomoduese shtesë/ndërtesa ekzistuese të cilat më pas do t'i nënshtrohen rikonstruksionit dhe përshtatjes, për prokuroritë dhe gjykatat në rrethet Gjirokastrë, Vlorë dhe Durrës, pasi ndërkohë që Prokuroria e Përgjithshme ka realizuar detyrimet e saj sipas marrëveshjes, nga ana e palëve të tjera nuk janë respektuar detyrimet e ndërmarra.

Në mënyrë të përmbledhur aspektet e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2023, pasqyrohen më në detaje, sa më poshtë:

I. ORGANIZIMI I BRENDSHËM, GJENDJA, PROGRESI, PROBLEMATIKAT

Strukturat dhe burimet njerëzore

Në funksion të ruajtjes së nivelit të efektivitetit në veprimtarinë administrative e funksionale të prokurorive, garantimin e paanshmërisë, shpërndarjen e ekuilibruar të volumit të punës në zbatim edhe të hartës gjyqësore, me urdhrat nr. 1/2023, nr. 10/2023 dhe nr. 89/2023, të Prokurorit të Përgjithshëm, janë caktuar strukturat organike të prokurorive pranë gjykatave të shkallës të së parë të juridiksionit të përgjithshëm, apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Në vitin 2023 numri faktik i prokurorëve në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm ka qenë 198 (përfshirë dhe emërimet në korrik të 26 magjistratëve të rinj). Ky tregues evidenton strukturën faktike me 62 % të prokurorëve kundrejt numrit organik prej 321 prokurorësh dhe mungesën e 38 % të numrit të prokurorëve. Në këtë vështrim, gjendja e numrit faktik të prokurorëve sipas niveleve të prokurorive ka qenë: - 177 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, ose 101 prokurorë më pak krahasuar me numrin organik (64 % e strukturës organike); 10 prokurorë në prokurorinë pranë

Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ose 16 prokuror më pak krahasur me numrin organik (38 % e strukturës organike) dhe 11 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme ose 6 prokurorë më pak se numri organik (65 % e strukturës organike).

Kuadri nënligjor 2023

Udhëzime të përgjithshme dhe akte normative me rëndësi në aspektin organizativ dhe funksional të miratuara në vitin 2023 mund të përmendim: udhëzimin e përgjithshëm, nr. 01, datë 26.01.2023 “Për masat administrative dhe proceduralee për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”, udhëzimin e përgjithshëm nr. 02, datë 12.05.2023 “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”; urdhrat “Për caktimin e personelit në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 3/2019, i ndryshuar, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2023, “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022”, “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e ‘Rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023’”; Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme dhe Bankës së Shqipërisë “Për rritjen e efikasitetit në parandalimin dhe mbrojtjen e monedhave nga falsifikimi dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në këtë fushë” nr. 57 prot., i Prokurorisë së Përgjithshme, datë 17.01.2023; Marrëveshja e Bashkëpunimit “Për funksionimin e mekanizmit kombëtar të referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave”, nr. 1311 prot., datë 14.08.2023 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe organizata me objekt veprimtarie këtë fushë.

Mbi dixhitalizimin

Prokuroria e Përgjithshme e ka konsideruar thelbësore për rritjen e efikasitetit së punës, ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjes. Për këtë qëllim, me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 04 datë 09.01.2023 u ngrit grupi i punës për përgatitjen e dokumentacionit përkatës për krijimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjes.

Në mbështetje të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, Bashkimi Evropian është angazhuar për të mbështetur financiarisht ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, dhe për këtë arsye, fondi i akorduar me buxhetin e vitit 2023 për fazën e parë të investimit nuk u përdor. Për sa më sipër, me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 04, datë 04.01.2024 është ngritur grupi i ekspertëve mbështetës për sistemin e qendëruar të çështjeve për të siguruar mbështetje dhe koordinim sa më efektiv të prokurorisë për realizimin e këtij projekti.

Ndërkohë është bashkërenduar puna me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë dhe është hartuar korniza e ndërveprimit të sistemeve të reja të sistemit të drejtësisë (ku përfshihet edhe sistemi CAMS) e cila përfshin ndër të tjera ndërlidhjen e sistemeve elektronike të tyre ndërmjet njëri-tjetrit, por edhe me bazat e të dhënave shtetërore me protokolle informatike, për një komunikim sa më eficient dhe të sigurtë.

Policia gjyqësore

Prokurori i Përgjithshëm mbi bazën e shkeljeve të evidentuara në vitin 2023, ka kërkuar fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore për 2 oficerë të policisë gjyqësore.

Spektori i Monitorimit, në Prokurorinë e Përgjithshme, në zbatim të udhëzimit nr. 10/2021 “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”, i ndryshuar, ka monitoruar, analizuar dhe vlerësuar të dhënat statistikore të nxjerra nga sistemi *Statistikat e veprimeve hetimore të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë* si dhe ka përgatitur informacione përmbledhëse periodike 3-mujore për Prokurorin e Përgjithshëm për gjetjet nga monitorimet duke propozuar zgjidhje konkrete.

Është urdhëruar 1 inspektim tematik për saktësinë në hedhjen e të dhënave në sistem në përfundim të të cilit u konstatuan shkelje nga 23 oficerë të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Prokurori i Përgjithshëm, pas njohjes me rezultatet e inspektimit, ka kërkuar zbatimin me korrektesë të udhëzimit nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore dhe marrjen e masave nga ana e drejtuesve për sigurimin e saktësisë së të dhënave të hedhura.

Marrëdhëniet me median

Një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme, në funksion të rritjes së transparencës dhe të besimit të publikut ka qenë pasqyrimi i gjerë dhe cilësor në media i punës së prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm në të gjitha nivelet. Në këtë kuadër, është shtuar ndjeshëm intensiteti dhe sasia e informacionit që i është komunikuar medias, përmes një angazhimi më të madh të prokurorive të shkallës së parë në përcjelljen e informacionit dhe publikimin e tij. Prokuroria e Përgjithshme përmes një qasje proaktive dhe dinamike, ka nxitur, mbështetur dhe koordinuar prokuroritë dhe prokurorët e mediave për të forcuar ndërveprimin e tyre me median dhe publikun, çka besojmë se ka rritur dukshëm vizibilitetin e punës së kryer përgjatë gjithë vitit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar pasqyrimin të punës edhe në faqen zyrtare të institucionit si dhe në profilin zyrtar të tij rrjetin X, ku përveç njoftimeve zyrtare mbi hetimet, gjykimet apo veprimtari të ndryshme institucionale, vazhdimisht janë publikuar të dhëna specifike të nxjerra nga raportet vjetore mbi gjendjen e kriminalitetit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së informacionit të transmetuar nisur nga një këndvështrim më analitik dhe përgjithësues i fenomeneve kriminale.


II. VEPRIMTARIA E PROKURORIVE, PROBLEMATIKAT DHE ÇËSHTJET QË KËRKOJNË VËMENDJE

1. Veprimtaria e prokurorive të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm

Raporti mbi gjendjen e kriminalitetit, ku përfshihet dhe raporti mbi ngarkesën e punës së prokurorive për vitin 2023 që i janë vënë në dispozicion këtij Këshilli, paraqesin të dhëna të hollësishme për treguesit e punës dhe ecurinë e veprimitarisë për të gjithë prokuroritë.

Në këtë raportim, vlerësojmë të ndalemi në disa tregues të performancës së prokurorive, problematikat dhe disa çështje që kërkojnë vëmendjen tuaj.

Gjatë vitit 2023, në organin e prokurorisë janë trajtuar 55253¹ materiale kallëzuese që përbën një ulje prej 9,4 % në krahasim me vitin 2022. Janë ndjekur gjithsej 45715 procedime penale, që përbëjnë një ulje prej 5,2 % në krahasim me vitin 2022, nga të cilat 24095 janë procedime penale të regjistruara, me një ulje prej 6,2 % në krahasim me vitin 2022 dhe 2101 procedime penale të rifilluara, që tregon ulje prej 70 % në krahasim me vitin 2022. Janë mbartur 21011 procedime penale me një ulje prej 3,9 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2022. Është vendosur mosfillimi për 9946 referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një ulje prej 22,2 % në krahasim me vitin 2022.



¹ Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2023 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2023; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2023 pa procedimet e regjistruara sipas kodit penal ushtarak.

Gjatë vitit 2023 janë përfunduar 23419 çështje që përbën ulje prej 9,41 % të çështjeve të përfunduara krahasuar me vitin 2022, prej të cilave: 41,21 % janë dërguar për gjykim, 25,76 % janë pushuar, 30,04 % janë pezulluar dhe 2,99 % janë transferuar në prokuroritë kompetente.

Janë dërguar në gjykatë 9652 çështje me akuzë ndaj 11401 të pandehurve. Krahasimisht me vitin 2022 rezulton një ulje prej 12,13 % e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë dhe 11,87 % e numrit të të pandehurve dërguar në gjykatë. Raporti ndërmjet çështjeve dërguar në gjykatë dhe çështjeve të pushuara është 61,54 % me 38,46 %.

Në lidhje me vendimet e gjykatës, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 janë dënuar 7254 të pandehur që krahasuar me vitin 2022 përbën ulje 31,22 % të numrit të pandehurve të dënuar, dhe për 199 të pandehur është dhënë vendim për deklarimin të pafajshëm ose për 2,67 %.

Siç u paraqit më lart, evidentohet se përgjithësisht ka tendencë në ulje të numrit të procedimeve të regjistruara. Vlerësojmë se në këtë ulje ka patur ndikim edhe Memorandumi i Bashkëpunimit me Policinë e Shtetit dhe udhëzimi mbi zbatimin e nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale dhe trajtimin e referimeve të tjera që dukshëm nuk përmbajnë elementë të ndonjë veprë penale, në bazë të të cilave për vitin 2023 rezultojnë 4588 materiale.

Këto akte nënligjore, ashtu si dhe institutet e reja procedurale, urdhri penal dhe marrëveshja e fajësisë, synojnë të vijnë në ndihmë të prokurorëve për të ulur ngarkesën e panevojshme dhe për të mundësuar zgjidhje të shpejtë ligjore për çështje të një rrezikshmërie më të ulët. Megjithatë, këto institute siç vërehet nga shifrat më sipër, nuk rezultojnë të japin impaktin e duhur.


i) Performanca e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë

-Procedime të regjistruara/procedime të përfunduara² (Niveli i efikasitetit)


Të dhënat me numrin e procedimeve të regjistruara për secilën prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë përgjatë vitit 2023, paraqiten si më poshtë:

² Koment: Në kuadrin e këtij vlerësimi, numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2023, evidenton si tregues potencial volumin e procedimeve të regjistruara të prokurorive, ndërsa treguesi potencial i çështjeve të përfunduara konsiderohet i përmbushur për numrin e procedimeve/çështjeve të përfunduara brenda këtij viti. Të dhënat për “procedimet e regjistruara” evidentojnë ngarkesën e prokurorive përkatëse, tregues me të cilin lidhet pritshmëria e publikut për punën e secilës prokurori. Ndërsa, indikatorin “procedime të përfunduara” tregon kapacitetin e secilës prokurori për të përfunduar brenda afateve ligjore hetimet paraprake në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore.

Procedime të regjistruara për vitin 2023



Analiza në përqindje e raportit të çështjeve të përfunduara me procedimet e regjistruara në secilën prokurori për vitin 2023, paraqitet si vijon:



Ky raport paraqet performancën lidhur me efikasitetin³ e punës së prokurorive përgjatë vitit 2023 pas standardit europian (Cepej), ku pasqyrohet gatishmëria dhe mundësia e secilës prokurori për të përfunduar brenda vitit procedimet e regjistruara.


³ Koment: Në vështrim të performancës leximi i përqindjeve të efikasitetit janë: kur vlera është më e vogël se 100% tregon se prokuroria nuk ka arritur të përfundojë të gjitha procedimet e regjistruara, kur vlera është 100% tregon se prokuroria ka qenë plotësisht efikase në përfundimin/zgjidhjen e procedimeve të regjistruara, dhe kur vlera është më e lartë se 100% tregon se prokuroria ka arritur të përfundojë më shumë procedime se sa ka regjistruar, duke ulur numrin e procedimeve të mbartura nga viti paraardhës.

-Procedime në ndjekje/procedime të përfunduara⁴ (Shkalla e mbingarkesës në prokurori)

Të dhënat e volumit të punës sipas prokurorive për vitin 2023 paraqiten në grafikun më poshtë:



Në grafikun më poshtë paraqitet përqindja e raportit të procedimeve të përfunduara me çështjet në ndjekje/hetim (mbartura dhe regjistruara, etj), në çdo prokurori për vitin 2023.




⁴ Koment: Në këtë tregues të performancës, referuar numrit të procedimeve/çështjet të mbartura dhe procedimeve të regjistruara (procedimet/çështjet në ndjekje), parashtroj vlerësimin e efikasitetit që do t'i duhej prokurorëve në vitin 2022, për të përfunduar procedimet e mbartura dhe procedimet e regjistruara të reja, nëse trendi i volumit të punës dhe numrit të prokurorëve do të ishte në të njëjtat shifra.

Raporti më sipër evidenton se 11 prokurori kanë tregues nën 50 % të çështjeve të përfunduara brenda vitit 2023, rrethana që evidentojnë nevojën për të vlerësuar dhe plotësuar vakancat.

Konkretisht vërehet se Prokuroria Sarandë ka performancën më të ulët pasi janë përfunduar vetëm 28 % e procedimeve në ndjekje, dhe vijon me rend rritës në Gjirokastrë, Korçë, deri në 32 %. Tregues me performancë më të lartë vërehen në prokuroritë Shkodër e Kukës, që kanë përfunduar mbi 65 % të procedimeve në ndjekje ndërkohë që në prokuroritë e tjera ky raport varion nga 37 % deri 49 %.

-Ngarkesa e prokurorëve⁵

Ngarkesa mesatare për çështjet e përfunduara sipas numrit faktik të prokurorëve në vitin 2023 në paraqitjen grafike më poshtë janë: -më e larta 169 çështje të përfunduara në Prokurorinë Kukës, dhe -më e ulta 90 çështje të përfunduara në Prokurorinë Gjirokastrë.




-Në analizë të performancës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, ku evidentohet përqindja që zënë procedimet e regjistruara dhe procedimet e mbartura në volumin e punës, përqindja që zë raporti i procedimeve të përfunduara me procedimet në ndjekje, dhe procedimeve të përfunduara me procedimet e regjistruara, të dhënat janë si vijon:

⁵ Koment: Ky tregues/indikator që përfaqëson numrin mesatar të procedimeve/çështjeve të përfunduara nga një prokuror brenda një viti, e përlogaritur me numrin e procedimeve/çështjeve të ndjekura (mbartura dhe procedimeve të regjistruara) gjatë vitit 2021 në raportë me numrin e prokurorëve të angazhuar gjatë këtij viti, pa u trajtuar niveli/shkalla e vështirësive sipas natyrës së çështjeve për mungesë të treguesve, evidentohet se mesatarja e çështjeve të përfunduara për çdo prokuror sipas numrit faktik të prokurorëve është sipas prokurorive.


	<i>Raporti i procedimeve të regjistruar në totalin e volumit</i>	<i>Raporti i procedimeve të mbartura në totalin e volumit</i>	<i>Raporti i procedimeve të përfunduara me procedimet në ndjekje</i>	<i>Raporti i procedimeve të përfunduara me procedimet e regjistruara</i>	<i>Mesatarja për prokuror çështje ndjekura (numri faktik)</i>
Berat	30%	56%	37%	125%	420
Dibër	29%	42%	42%	146%	318
Durrës	40%	31%	37%	95%	295
Elbasan	40%	46%	42%	105%	285
Fier	43%	49%	43%	100%	369
Gjirokastrë	35%	43%	31%	88%	294
Korçë	37%	41%	32%	87%	387
Kukës	55%	19%	65%	118%	259
Lezhë	58%	23%	49%	84%	298
Saranda	37%	41%	28%	75%	471
Shkodër	54%	34%	67%	122%	226
Tiranë	49%	34%	45%	92%	313
Vlorë	42%	46%	38%	91%	257

-Raporti i numrit mesatar të procedimeve të regjistruara sipas numrit organik dhe faktik të prokurorëve dhe sipas prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë paraqitet në vijim:

Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit organik




Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit faktik




Mesatarja e çështjeve të regjistruara gjatë vitit 2023 në raport me numrin faktik të prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm në rang vendi, rezulton të jetë 136 procedime penale për çdo prokuror, një nga treguesit që nevojitet të mbahet në konsideratë për shpërndarjen e balancuar e numrit të prokurorëve në rang vendi. Nga të dhënat rezulton se rreth kësaj mesatare afrohen prokuroritë Shkodër, Kukës, Korçë e Berat ku mesatarja e regjistrimeve të reja varion nga 123 në 143 procedime.

-Raporti i numrit mesatar të procedimeve në hetim sipas numrit organik dhe faktik të prokurorëve dhe sipas prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë paraqitet në vijim:

Ngarkesa mesatare në hetim për çdo prokuror sipas numrit organik




Ngarkesa mesatare në hetim për çdo prokuror sipas numrit faktik



- Raporti i numrit mesatar të procedimeve në ndjekje sipas numrit faktik të prokurorëve dhe sipas prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë paraqitet në vijim:


Ngarkesa mesatare në ndjekje për çdo prokuror sipas numrit faktik



Nëse do të llogarisim ngarkesën mesatare faktike bazuar në procedimet në ndjekje (regjistruara dhe të mbartura), situata rezulton shumë e rënduar në prokuroritë Sarandë, Berat, Fier, Korçë, me një mesatare të ngarkesës nga 301 në 371 procedime për çdo prokuror, ndërsa ngarkesa mesatare faktike më e ulët është në prokuroritë Kukës, Shkodër, Durrës ku varion nga 199 në 209 procedime.

2. Veprimtaria e Prokurorisë së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm

Ngarkesa e Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ku përfshihen “çështje themeli dhe masa sigurimi”, për vitin 2023 paraqitet në grafikun më poshtë:



Ngarkesa mesatare për prokurorë faktikë në vitin 2023, rezulton të jetë 372 çështje.

Lidhur me treguesit e performancës së Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, që evidenton numrin e kërkesave para gjykatës dhe çështjeve që prokurorët e apelit kanë përfunduar në gjykatën e apelit për vitin 2023 paraqitet si vijon:

- rezultojnë gjithsej 3853 kërkesa për çështje themeli dhe masa sigurimi, përfshirë heqje dorë nga ankimi, - ndërkohë që janë përfunduar gjithsej 3715 çështje themeli dhe masa sigurimi. Raporti në përqindje i çështjeve të përfunduara me çështjet e regjistruara për vitin 2023 është 96,42 %.

Ky raport evidenton dhe efikasitetin e punës së apelit brenda vitit 2023, ku pasqyrohet gatishmëria dhe mundësia e kësaj prokurorie për të përfunduar brenda vitit çështjet e regjistruara.⁶

⁶ Në këtë vështrim, kur vlera është më e vogël se 100% tregon se prokuroria e apelit nuk ka arritur të përfundojë të gjitha çështjet e regjistruara, kur vlera është 100% tregon se prokuroria e apelit ka qenë plotësisht efiçase në përfundimin e çështjeve të regjistruara, dhe kur vlera është më e lartë se 100% tregon se prokuroria ka arritur të përfundojë më shumë procedime se sa ka regjistruar, duke ulur dhe numrin e procedimeve të mbartura nga viti paraardhës.

Veç sa më sipër, referuar disa treguesve të tjerë të performancës së prokurorisë së apelit, gjatë vitit 2023, evidentohet se prokurorët e apelit:

- kanë hequr dorë në 33,67 % të ankimeve të ushtruara nga prokurorët të shkallës së parë për çështje themeli dhe në 30,17 % të rasteve është kërkuar heqja dorë nga caktimi i masës së sigurimit;

- kanë kërkuar në 3,89 % të kërkesave lehtësim të pozitës së të pandehurit (vetëm në 7,27 % të rasteve gjykata ka vendosur lënie në fuqi të vendimit);

- kanë kërkuar në 1,1 % të kërkesave prishjen e vendimit dhe vendosjen e pushimit ose pafajësi (në 37,50 % të rasteve gjykata ka vendosur lënie në fuqi të vendimit);

- kanë kërkuar në 1,55 % të kërkesave prishjen e vendimit dhe kthimi i akteve (në 29,17 % të rasteve gjykata ka vendosur lënie në fuqi të vendimit);

- gjykata ka mbështetur kërkesën e prokurorit të apelit për lënie në fuqi të vendimit të shkallës së parë në 78,76 % të rasteve dhe kërkesën e prokurorit për rëndimin e pozitës së të pandehurit në 56,86 % të rasteve.

- lidhur me masat e sigurimit gjykata ka mbështetur kërkesën e prokurorit për lënien në fuqi të masave të sigurimit në 84,72% të rasteve.

3. Veprimtaria e Prokurorisë së Përgjithshme

Në përmbushje të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, veprimtaria e Prokurorisë së Përgjithshme, përgjatë vitit 2023, ka vijuar në realizimin e misionit kushtetues e procedurale të përfaqësimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, objektivave prioritare, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me prioritetet e shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritit, ushtrimit të funksioneve të caktuara me ligj në kuadër të përfaqësimit të prokurorisë në ndihmën e ndërsjellë në çështje penale të juridiksionit të përgjithshëm, dekriminalizimit, përgjimeve procedurale, si dhe të angazhimeve në kuadër strategjive ndërinstitucionale.

Përveç sa u trajtua më sipër në këtë raport, lidhur me aktivitete e veprimtari të tjera të strukturave të Prokurorisë së Përgjithshme përmendim:

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar organin e akuzës pranë Gjykatës së Lartë në 51 çështje, prej të cilave 30 gjykime themeli (nga 65 gjykime themeli në vitin 2022), 2 përfaqësime në gjykime për të njëjshuar/ndryshuar praktikën gjyqësore dhe 19 mendime për çështje të shqyrtuara në dhomë këshillimi, si dhe në cilësinë e subjektit të interesuar pranë Gjykatës Kushtetuese për 22 çështje (nga 11 çështje në vitin 2022).

Ndërkohë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale janë marrë 82 vendime për zgjidhje të mosmarrëveshjeve për kompetencën (tokësore) mes prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë vitit 2023, ka trajtuar:

- 171 praktika ekstradimi nga jashtë drejt Shqipërisë, ndër të cilat janë përfunduar 45.
- 99 praktika ekstradimi nga Shqipëria për jashtë, ndër të cilat janë përfunduar 48.
- 431 letërporosi nga jashtë drejt Shqipërisë, ndër të cilat janë përfunduar 229.
- 491 letërporosi nga Shqipëria drejt vendeve të tjera, ndër të cilat janë përfunduar 152.
- 185 praktika shpallje në kërkim ndërkombëtar dhe 103 praktika heqje nga kërkimi ndërkombëtar
- 280 urdhër arreste ndërkombëtare të lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë të cilët nuk mund të ekstradohen për shkak të shtetësisë shqiptare, nga të cilat 125 të përfunduara;
- 47 praktika transferimi i të dënuarve nga jashtë;
- 2 praktika transferimi i të dënuarve për jashtë;
- 33 praktika njohje e vendimeve penale nga jashtë;
- 8 praktika njohje e vendimeve penale nga jashtë;
- 22 praktika transferimi të procedimeve nga jashtë;
- 16 praktika transferimi të procedimeve për jashtë;
- 495 praktika të tjera të ndryshme;
- 43 hetime pasurore.

Në Sektorin e Dekriminalizimit në Drejtorinë e Koordinimit Institucional, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për vitin 2023, janë regjistruar 91 kërkesa për verifikim të plotë të të dhënave të formularëve të vetëdeklaruar të personave, subjekt i këtij ligji, të ardhura nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve dhe Departamenti i Administratës Publike, prej të cilave janë regjistruar 77 procese të reja.

Është ndjekur procesi i verifikimit të thelluar të të dhënave të vetëdeklaruar në formular, për 155 subjekte.

Për 85 subjekte vetëdeklarues është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit, ndërkohë që 70 raste vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr. 138/2015 dhe vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2023 është përdorur përgjimi i komunikimeve elektronike nga prokurorët në fazën e hetimeve paraprake si mjet për sigurimin e provës në 514 procedime penale. Është realizuar përgjimi për 2675 pajisje fundore në përdorim të 2492 subjekteve ndaj të cilëve ishte lejuar përgjimi. Në total janë ekzekutuar 1121 vendime për përgjim të autorizuar nga gjykata dhe 456 urdhra/autorizime të prokurorit.

4. Monitorimi, gjendja, problematikat dhe mbështetja që kërkohet

Prokurori i Përgjithshëm, në kuadrin e kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë dhe mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, përgjatë vitit 2023, për të monitoruar si zbatimin, ashtu dhe si kanë ndikuar udhëzimet e përgjithshme në gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara dhe efektivitetin e ushtrimit të ndjekjes penale në fushat përkatëse, periodikisht ka vijuar kërkesat për informacione drejtuesve të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm lidhur me masat e marra në zbatim të kompetencave ligjore të tyre, nëse kanë nxjerrë udhëzime të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, apo për kërkimin e informacionit për ecurinë e procedimeve dhe/ose për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët lidhur me çështje konkrete, apo nxjerrjen e urdhrave për policinë gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre, dhe nëse kanë marrë masa për koordinimin e veprimtarisë me prokuroritë e tjera.

Gjejmë me vend të theksojmë se pavarësisht arritjeve, prokuroritë vijojnë të përballen me sfida dhe problematika në menaxhimin e ngarkesës së lartë të punës por edhe në nivelin jo të kënaqshëm të koordinimit dhe rolit aktiv të drejtuesve në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete dhe marrjes së masave të plota administrative dhe/ose procedurale për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe rekomandimeve të rezolutës, rekomandimeve prioritare, detyrimeve në kuadër të procesit të integritetit dhe më pas në mbikëqyrjen apo ndjekjen efektive të tyre.

Një problem konstant për drejtuesit mbetet organizimi dhe mbikëqyrja e punës së oficerëve të policisë gjyqësore, ku duhet theksuar se roli i tyre është i zbehtë dhe pasiv, ndërkohë që janë siguruar instrumenta ndihmëse shtesë për të siguruar një efikasitet më të lartë të seksioneve të policisë gjyqësore. Këtu do të veçoja sistemin e ri të raportimit të veprimeve hetimore të oficerëve të policisë gjyqësore, nga i cili kanë rezultuar probleme të ndryshme në mënyrën si funksionojnë seksionet, si p.sh. në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës së punës apo volumin e veprimeve hetimore të kryera. Roli pasiv i drejtuesve në këtë aspekt ndikon në performancën e zyrave që ata drejtojnë dhe ndihet nevojë për një qasje më dinamike prej tyre në të ardhmen.

Nisur edhe nga ankesat e qytetarëve, rezulton se në një masë relativisht të ndjeshme duhet përmirësuar cilësia e komunikimit me qytetarët në drejtim të dhënies së informacionit të kërkuar prej tyre në kuadër të hetimeve penale.

Në një pjesë të prokurorive ka nevojë për një aplikim më efikas të udhëzimit mbi zbatimin e nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale dhe trajtimin e referimeve të tjera që dukshëm nuk përmbajnë elementë të ndonjë vepre penale, që ndikon në uljen e ngarkesës së punës.

Nisur edhe nga gjetjet e inspektimit të kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë sa i përket zbatimit të udhëzimit nr. 12/2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm (i ndryshuar)”, i kërkuar ky nga Prokurori i Përgjithshëm, shfaqet nevoja që në tërësi drejtuesit dhe prokurorët të ndjekin më me përpikmëri zbatimin e tij, në kuadër të garantimit të transparencës së marrëdhënieve brenda prokurorive por edhe në drejtim të evidentimit më të mirë të cilësisë së punës së magistratëve, që do t’i shërbente edhe procesit të vlerësimit. Në këtë kuadër, këtë vit do të ketë një vëmendje të shtuar nga Prokuroria e Përgjithshme sa i përket zbatimit të udhëzimit në fjalë.

III. BASHKËPUNIMI DHE MBËSHTETJA

Bashkëpunimi ndërinstytucional, përfshirja në proceset konsultuese të akteve ligjore e nënligjore dhe mbështetja nga projektet e misionet ndërkombëtare, ka qenë një aspekt i rëndësishëm në zhvillimin e objektivave dhe prioriteteve institucionale.

Gjatë vitit 2023 Prokuroria e Përgjithshme ka kontribuar me dhënien e mendimeve për reformimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor të dërguar kryesisht nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme.

Një kontribut të rëndësishëm edhe në vitin 2023 ka patur angazhimi me organizata të shoqërisë civile, kryesisht në fushën e të drejtave të njeriut, por jo vetëm, të cilat në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet aktiviteteve ndërgjegjësuese, monitoruese e trajnuese, i shërbejnë përmirësimit të sistemit të ndjekjes penale.

Po kështu, me mbështetjen e BE-së nëpërmjet projekteve si EU4lea, EU4focal, OSBE, e partnerë të tjerë ndërkombëtarë, edhe gjatë vitit 2023 janë realizuar një sërë aktivitete trajnuese dhe bashkëpunime të tjera të rëndësishme ku veçojmë manualin e hetimit të pastrimit të parave, një dokument i rëndësishëm që është kërkuar me këmbëngulje nga ana jonë si i domosdoshëm për të mbajtur cilësinë dhe qëndrueshmërinë e punës hetimore të seksioneve të pastrimit të parave, veçanërisht në kushtet aktuale ku për shkak të largimeve ndryshimi i prokurorëve pjesë e seksioneve është i pashmangshëm. Ky manual, është përfunduar dhe do të prezantohet për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore këto ditë.

Bashkëpunimi me Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Përgjatë vitit 2023, bashkërendimi dhe koordinimi në marrëdhëniet me Këshillin e Lartë të Prokurorisë është fokusuar në çështjet si më poshtë:

-në drejtim të zbatimit të hartës së re gjyqësore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

- në mbledhjen dhe dhënien e informacionit të nevojshëm nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm me qëllim vlerësimin e punës së prokurorëve dhe drejtuesve. Megjithatë, çmujmë se zgjidhja optimale dhe përfundimtare për këtë proces do të jetë përfshirja në CAMS edhe e kërkesave për informacion statistikor lidhur me procesin e vlerësimit. Në këto kushte, do të jetë i nevojshëm vijimi i bashkëpunimit me KLP edhe në nivel teknik. Ndërkohë e vlerësojmë pozitivisht qasjen e KLP në kuadër të procesit të vlerësimit të veprimtarisë së drejtuesve, duke kërkuar mendimin e Prokurorit të Përgjithshëm për disa aspekte të rëndësishme të punës së tyre.

Përtej sa më sipër, do të vlerësonim si efektiv dhe në shërbim të punës së të dy institucioneve, konsultimin paraprak nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në nxjerrjen e akteve normative të cilat ndikojnë ose ndërlidhen me çështje në fushën e përgjegjësisë së Prokurorit të Përgjithshëm.

Bashkëpunimi me Prokurorinë e Posaçme

Bashkëpunimi e koordinimi ndërmjet prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme përgjatë vitit 2023 ka vijuar në zbatim të ligjit dhe Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional, (datë 15.12.2020), ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme, në organizim takimesh në nivel qendor dhe në kuadër të veprimtarisë procedurale në nivel vendor.

Bashkëpunimi me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë

Bazuar në kuadrin ligjor dhe në përputhje me angazhimet e ndërmarra me marrëveshjen e bashkëpunimit/2021 “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve/prokurorëve në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, Prokurori i Përgjithshëm gjatë vitit 2023 ka propozuar dy inspektime tematike. Ndërkohë po ndiqen me vëmendje si koordinimi në kuadër të inspektimeve dhe kërkesave të tjera institucionale të ILD, ashtu edhe gjetjet e raporteve të inspektimit.

Sa i përket shkeljeve individuale të konstatuara, për një magjistrat/gjyqtar pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm i është dërguar kërkesë për inicim të procesit të hetimit/inspektimit Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe i është dërguar për vlerësim Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë ankesa e një shtetasi ndaj një magjistrati/prokuror pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

Nga ana jonë bashkëpunimi me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë vlerësohet si thelbësor në mbarëvajtjen e punës në sistemin e drejtësisë, ndaj e shohim me prioritet përmirësimin e ndërveprimit institucional në mënyrë që inspektimet t'i shërbejnë rritjes së cilësisë së punës në sistemin e prokurorisë.

Bashkëpunimi dhe veprimtaria e Komisionit të Policisë Gjyqësore

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstytucional, referuar në informacionin e Komisionit të Policisë Gjyqësore, përgjatë vitit 2023 në zbatim të kompetencave ligjore për përgjegjësinë disiplinore të oficerëve të policisë gjyqësore, Komisioni mbi bazën e kërkesave të subjekteve të parashikuara nga neni 35 i ligjit nr. 25/2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", ka vendosur fillimin e procedimit disiplinor ndaj 7 (shtatë) oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe ka patur në shqyrtim gjatë këtij viti 2 (dy) procedime disiplinore të mbartura nga viti 2022. Nga këta, 6 oficerë të policisë gjyqësore të proceduar disiplinorisht i përkasin shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit, kurse 3 oficerë të policisë gjyqësore të proceduar disiplinorisht i përkasin seksioneve të prokurorisë.

Gjatë kësaj periudhe Komisioni ka përfunduar shqyrtimin e procedimit disiplinor për 4 (katër) raste, lidhur me 5 procedime disiplinore të regjistruara gjatë vitit 2023, vijon shqyrtimi i tyre.

Në zbatim të nenit 29, pika 2, të ligjit nr. 25/2019 dhe procedurave që parashikohen në "*Rregulloren për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të oficerëve të policisë gjyqësore*", mbi bazën e vlerësimeve me pikë të dërguar nga drejtuesit e prokurorisë, Komisioni ka kryer vlerësimin e oficerëve të policisë gjyqësore, për vitin 2022, për 127 oficerë të Policisë Gjyqësore.

Referuar vlerësimeve të drejtuesve të prokurorisë të shkallës së parë, Komisioni klasifikoi në kategorinë "Shumë mirë" - 75 vlerësime, "Mirë" 44 vlerësime; "Mjaftueshëm" - 7 vlerësime; "I paaftë" - 1 vlerësim.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i vlerësimeve të performancës së oficerëve të policisë gjyqësore të dërguara nga drejtuesit e prokurorisë të shkallës së parë, evidentohet se ky proces nuk ka marrë vlerësimin e duhur nga të gjithë drejtuesit e prokurorisë, si një proces i detyrueshëm i cili ka për qëllim të evidentojë aftësitë, efikasitetin, kualifikimin dhe integritetin e oficerëve të Policisë Gjyqësore. Duke qenë se vlerësimi i oficerëve të policisë gjyqësore është një element i rëndësishëm që ndikon në ecurinë në karrierë të tyre, Komisioni bëri ndryshime në Rregulloren për Vlerësimin e Oficerëve të Policisë Gjyqësore duke parashikuar mekanizma parandalues të vlerësimeve të pambështetura objektivisht në treguesit realë të aktivitetit të policisë gjyqësore nga ana e drejtuesve.